

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE, KORÇE**

Nr. _____prot.

Datë 27.05.2021

Për: *Shqerine, O L S I SHPK me NIPT J63423463I adresa : Fier Patos GRIZ Fshati Grize. Rruga Fier-Patos. Banesa ne KM 6 (OLSI) SHPK.*

Procedura e prokurimit: Procedure e hapur me objekt : **“Karburant” Loti i 1 Naftë**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-93593-04-20-2021**

Loti i 1 Naftë REF-93603-04-20-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me karburant te mjeteve sipas kerkesave te autoritetit kontraktor te parashikuara ne dokumentet e tenderit me afat 12 (dymbedhjete) muaj nga data e lidhjes se kontrates.*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **me marzh fitimi më të ulët**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria “MEROLLI OIL”SHPK me nr. NIPT: K04005080H me marzh fitimi: 3.49%(tre pikë dyzet e nëntë përqind)

2. Shoqeria O L S I SHPK me nr. NIPT: J63423463I me marzh fitimi: 3.5%(tre pikë pese përqind)

3. Shoqeria “AROIL”SHPK me nr. NIPT: L44324002H me marzh fitimi:5%(pese përqind)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1 . Shoqeria “MEROLLI OIL”SHPK per arsye se:

Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të parashikuara ne kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve standarte të tenderit ku është kërkuar;

"Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri". Sipas Vërtetimit nr. 163 të datës 07.04.2021 nënshkruar nga OSHEE nuk vërtetohet shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike për muajin mars 2021, detyrime të cilat janë maturuar dhe duhet të jene shlyer brenda muajit prill 2021, referuar datës së tenderit i cili është hapur në datën 11.05.2021.

2 . Shoqeria “AROIL”SHPK per arsye se:

Operatori ekonomik nuk vërteton përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit , kapaciteti teknik pika c), të dokumenteve të tenderit ku është kërkuar: Raport analizë të cilësisë së karburantit (naftë) të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI). Raport Analiza duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga data e hapjes së tenderit". Operatori ekonomik për përmbushjen e kriterit ka paraqitur raport analizën me nr. 243/2 prot. të datës 08.02.2021.

Referuar datës së hapjes së procedurës që është data 11.05.2021 rezulton se raport analiza e kërkuar nuk është brenda tre muajve nga data e hapjes së tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Shoqerine O L S I SHPK me NIPT J63423463I adresa : Fier Patos GRIZ Fshati Grize. Rruga Fier-Patos. Banesa ne KM 6 (OLSI) SHPK* se oferta e paraqitur **me marzh fitimi 3.5 %** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarrjes se Sherbimeve Publike,Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kerkesa per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, Autoriteti Kontraktor do të anulojë procedurën e prokurimit në zbatim të Nenit 98 pika b) të Ligjit 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Sqarim: Kjo procedurë prokurimi është hartuar mbështetur në parashikimet e Ligjit 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Për sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj do të merren për bazë parashikimet e akteve nënligjore të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.05.2021

Ankesa: **Nuk ka**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ILIRJAN DINELLARI**